

PROCESVERBAL IV/2021

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 4 (katërt) të rregullt për vitin 2021 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	30.04.2021
Ora:	10.00

Prezentë në takim:

Z. Nexhat Ramadani
Z. Bashkim Ndrecaj
Z. Brahim Curri
Z. Alban Berisha
Z. Shefket Kolgeci
Z. Xhemajl Kabashaj
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj. Shqipe Ramaj
Z. Lirim Qatani
Z. Reshat Selimaj
Z. Ardian Kotorri
Z. Bexhet Kuçi
Z. Aziz Bytyqi
Z. Gazmend Gashi
Znj. Bardha Gashi
Znj. Mirlinda Muqa

Z. Rilind Krasniqi
Z. Jeton Rrakaqi
Z. Arbërim Basha
Z. Dardan Berisha
Znj. Marigona Gashi
Znj. Florie Bytyqi
Z. Sami Hajdari
Znj. Shkëndije Zenelaj
Z. Osman Selimaj
Z. Leonard Shala
Z. Dugagjin Palushi
Znj. Laureta Tafaj
Z. Gëzim Kryeziu
Znj. Afërdita Morina

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Habibe Bytyqi
Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi dhe e prezantoi rendin e ditës:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimeve;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e vlerës së bonus banimit për vitin 2021;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri - alokimin e mjeteve branda fondit burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2021 nga projektet kapitale;**
- 5. Diskutimi i kërkesës së grupit parlamentar të PDK-së;**
- 6. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndetje për të gjithë. Para se ta hedhim në votim rendin e ditës a keni ndonjë kërkesë.

Jeton Rrakaqi - përshëndet gjithë të pranishmit. Kërkoj që sikurse vitin e kaluar të lirohen nga taksat gastronomit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në terasa jashtë lokalit. Kërkoj të futet në rend dite.

Nexhat Ramadani – përshëndet të pranishmit. Ne para një muaji kemi pas një seance e cila është ndërpre në mungesë të kuorumit ku kemi propozuar deklaratë për punët dhe projektet e Komunës dhe kam pas ftesë për të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare për ta vazhduar këtë seancë kërkojmë të vazhdohet seanca.

Kryesuesi – gjatë këtij mandati pothuaj katër vjeçar,ne kemi pas edhe në seanca tjera ndërprerje në përfundim të seancës në mungesë të kuorumit dhe realisht nuk kemi vazhdua në seancat tjera. Kjo nuk ka qenë e përgatitur, dhe ne si Kuvend punojmë mbas një rregullore si Kuvend i Komunës së Suharekës e cila është e miratuar.

Nexhat Rmadani – ne dimë që ka pas ndërprerje në pikën e fundit të seancës,dhe ne asnjëherë nuk kemi pas kërkesë për ta vazhduar,ndërsa sot ne po kërkojmë vazhdimin e seancës së kaluar e cila ka pas edhe një pikë mbas asaj pike që është ndërpre.

Derdan Berisha – përshëndet të pranishmit. Mendoj që është një trysni politike po donë me hup diskursin e këtij kuvendi Nexhat. Unë mendoj është më shumë presion politikë sesa deklaratë drejtuar Kryetarit. Ne si PDK nuk marrim asnjë përgjegjësi dhe nuk do të marrim pjesë në votime.

Nexhat Ramadani – Nuk është presion ndaj askujt,është e drejtë dhe obligim i gjithë delegatëve që janë në Asamble. Kemi ngrit një çështje në interes të qytetarëve. Është kërkesë normale,legjitime që të vazhdohet seanca është bërë anashkalim i vendimeve të Asamblesë.

Jeton Rrakaqi – ndërrimet e pushteteve kanë pas njëfarë amnisti për njëra tjetrën sa i përket keqpërdorimeve. Sa ke qenë drejtor i shërbimeve publike ke pas mjaft parregullsi. Deklaratat politike janë veq për konsum politik dhe propagandë.

Nexhat Ramadani – Jeton,ne nuk kemi asgjë,as me juve si PDK dhe me askënd tjetër. Po i jepni konotacion tjetër kërkesës sonë. Kërkesa përfundimtare e jona është që ju ta qitni në votim vazhdimin e seancës.

Jeton Rrakaqi – kur keni marrë iniciativa,ti kemi dhënë nënshkrimet. Nuk e ke pa të arsyeshme me gjet mbështetje prej nesh dhe nuk i ke lyp nënshkrimet.

Alban Berisha – kryesues, e përmendet që në rregullore nuk parashihet vazhdimi i seancës apo pika e cekur. Duhet të bëheni realist edhe ju. Ju ka ndodhur që edhe juve ju kanë munguar asamblistët dhe ne ju kemi plotësuar kur kemi të bëjmë me kuorumin. Çka nëse është pikë shumë e rëndësishme për qytetarët. Ka qenë dalje e orkestruar dalja nga seanca. Çka ndodh nëse nuk ka kuorum nëse ndërpritet një pikë shumë e rëndësishme për qytetarët, a vazhdohet a jo?

Xhemajl Kabashi – përshëndet të pranishmit. Kërkesa jonë është shumë e qartë, që të vazhdohet seanca e kaluar në pikën ku ka mbet.

Kryesuesi – nuk e hedh në votim seancën e kaluar. Ka përfunduar ajo.

Dardan Berisha – pika e rendit të ditës ka përfunduar, dhe ju po doni me votu deklaratën. Deklarata ka ardhë në mënyrë konspirative.

Alban Berisha – është mendim i juaji Dardan, por s'ka pas konspiracion.

Ardian Kotorri – ne si pikë e kemi mbështet, mirëpo ishte e pasinqertë nga ana e LDK-së ajo deklaratë që na ka ardh në momentet e fundit. Deklarata ka qenë tendencioze.

Nexhat Ramadani – nuk duhet të ndihet mire kryetari dhe ju si qeveri. Konspirative nuk ka pas tendencë. Ju kam ftuar me diskutuar për këtë çështje. Kërkojmë vazhdimin e seancës sepse është obligim ligjor.

Gëzim kryeziu – pse po vazhdohet të diskutohet për këtë pikë kur seanca qenka mbyllur. Unë po jap një propozim dhe ju po ma mohoni të drejtën, atëherë pse të rri. Propozoj të vazhdohet.

Shefket Kolgeci – përshëndet të pranishmit. Duhet të hidhet në rend dite a po vazhdon apo jo, është e drejtë e çdokujt.

Kryesuesi – kam thënë që seanca është mbyll.

Bashkim Ndrecaj – përshëndetje të gjithëve. Kryesues nuk më pëlqeve kur the që nuk e hedh në votim. Je i obliguar ta hedhësh në votim. Nëse kalon mire, dhe nëse nuk kalon mire.

- LDK largohet nga seanca.

Jeton Rrakaqi – rrini sepse tani do të votohet për një emër të madh. Jam i sigurt që njëra prej arsyeve është kjo.

Nexhat Ramadani – mos paragjykoni.

Kryesuesi – e hedh në votim rendin e ditë me pikën shtesë.

Miratohet Unanimisht

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – e hedh në votim.

Miratohet me 1 abstenim

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimeve;

Kryesuesi - jep sqarime për pikën e dytë rreth shfuqizimit të vendimeve.

Laureta Tafa – a është e domosdoshme që ky vendim të shfuqizohet nga Asambleja?

Avni Bytyqi – ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronave kërkon që kryetari ta konstatojë se pronarët që janë duke i shfrytëzuar pronat dhe nuk i kanë përmbush kontratat përmes komisionit atëherë i kërkohej Kryetarit që ta njoftojë Kuvendin dhe njëkohësisht Kuvendi të shfuqizojë vendimet paraprake.

Laureta Tafa – a është vendim i Asamblesë apo kompetence e kryetarit?

Avni Bytyqi – jep sqarime shtesë si zyrtar ligjor.

Dardan Berisha – në cilin vit janë dhënë këto parcela dhe cili është afati kohor për implementimin e Agro zones në Samadraxhë?

Kryetari – ka kërkesa që dojn me i shfrytëzu këto prona,sidomos në zonën industriale.Te agro zona janë katër pronarë që kanë fillu të punojnë,ne i kemi dërgu vërejtje dhe nëse nuk zbatohen si duhete, ne do ti shpallim dhe do ja japim atyre që kanë interes të punojnë.

Jeton Rrakaqi - pse kaq me ngulm në Samadraxhë,pse s’po ja nisni zones industriale ku ka më shumë parregullsi?

Kryetari - edhe te zona industriale jemi duke punuar dhe i kem disa prona qe janë në kontest gjyqësor. Është e pamundshme të kryhen të gjitha,dhe tash e kemi dhe një ankand publik.

Dugagjin Palushi – përshëndetje të gjithëve. Edhe unë e pata çështjen e njëjtë sikur Jetoni,kurse sa i përket operatorëve që nuk i përmbushin kushtet brena afatit kohor që parasheh ligji normal duhet me ja marrë dhe me vazhdua tutje. Këta operatorë përderisa nuk paguajnë obligimet ndaj Komunës kisha kërkuar që Komuna ti dërgoj te përmbaruesi.

Kryetari - obligimet e tyre figurojnë në ministrinë e financave,edhe me dasht nuk mund ti heqim.Te zona industriale janë disa lëndë në gjykatë,deri te gjykimi përfundimtar nuk mujm me marrë masa.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. . Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e vlerës së bonus banimit për vitin 2021;

Kryesuesi - jep sqarime lidhur me këtë pikë,dhe hap debatin.

Dardan Berisha - a është konfidenciale dhe a mundemi me ditë se cilat janë ato 7 familje të 2020-tës përfituese?

Besa Kuçi - janë 5 familje për momentin përfituese të bonus banimit,ndërsa dy familje janë përfituese nga fondacioni “Jetimat e Ballkanit”.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri - alokimin e mjeteve branda fondit burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2021 nga projektet kapitale;

Kryesuesi - elaboron këtë pike dhe hap debatin.

Dugagjin Palushi - dua ta di ridestinimin dhe tjetra pse nuk gjindet asnjë fond për me fillu të paktën procesi për ujë dhe kanalizim në Budakovë?

Kryetari - në KPF i kemi bart disa mjete për varreza në qytetin e Suharekës, kanalizim kemi me punu në Budakovë rrugë. Kem problem me çështjen e ujit. Çështja e ujit është çështje e ministrisë së zhvillimit ekonomikë ose hidroregjionit. Nuk po bëj politikë, kanalizim kem punuar vjet dhe kem me punuar edhe sivjet.

Dugagjin Palushi - iniciativën e merr Komuna e pastaj lyp fonde.Është nevojë e qytetarëve,dhe u bë një problem i pafund. Ju vet e preni shiritin dhe e lëshoni atë qeshmen.

Kryetari - është e vërtetë qe kem pre shirit. Është donacion i qeverisë zvicerane,vlera 500.000 euro në bashkëpunim me hidroregjionin në bashkëpunim me Komunën për

Mqitevë,Nëpërbisht,Reshtan,Reqan.Ka dy vite që janë gypat dhe presin për pumpa në Topallnicë,Reshtan dhe rruga Xhavit syla që hidroregjioni nuk shkon me lëshu ujin dhe ne si komunë nuk kem të drejtë.

Bëjeni një komision dhe takohuni me kryesitë e fshatrave Budakovë dhe Vraniq dhe mirrni vesh dhe pastaj ejani tek unë,unë do ta filloj.

Laureta Tafaj - kush deklarohet për me formu këtë komision dhe me fol me dy kryesitë e fshatrave?

Në komisionin për takim caktohen: Laureta Tafa, Dugagjin Palushi, Sami Hajdaraj, Reshat Selimaj, Shefket Kolgeci.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Diskutimi i kërkesës së grupit parlamentar të PDK-së;

Kryesuesi - jep sqarime rreth kësaj kërkesë dhe e lexon kërkesën e PDK-së.

Jeton Rrakaqi – Ne si grup parlamentar përmes Asamblesë i drejtohem Gjinnnazit”Jeta e Re” për vazhdimin e kësaj kërkesë.

Dardan Berisha - lexon deklaratën që Gjinnnazi ‘Jeta e Re” ta merr emrin e ri të heroit të kombit Fadil Vata . Ai po ashtu lexon biografinë e heroit tone kombëtar Fadil Vata.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime shtesë:Sipas udhëzimit administrative këshilli drejtues i shkollës të konsultohet me mësimdhënësit, prindërit dhe komunitetin e institucioneve. Kërkesa duhet të drejtohet në drejtorinë e arsimit, pastaj drejtoria e arsimit i dërgon kërkesat në ministrinë e arsimit. Dhe kjo është ekskluzivisht kompetencë e ministrisë së arsimit për emërtimin e shkollave. Ne mund ta dërgojmë vetëm si propozim për inicim ne shkollë.

Kryesuesi - e hedh në votim për inicim

16 për, 2 apstenime, Miratohet

Rilind Krasniqi - të ketë apstenime për heroin Fadil vata,qudi!

Laureta Tafaj - Fadil Vata nuk ka qenë i asnjë partie. Kisha propozu me dal me një peticion që qytetarët të shprehin mendimin e tyre për ndërrimin e emrit të shkollës.

Dugagjin Palushi - Fadil Vata gjithmonë do të mbetet hero,dhe nuk kem nevojë të tregohemi patrioti apo unë. Nuk jemi kundër,por Jeta e re është shqip.Është nder për neve që kemi sheshin,rrugën,shtëpinë muze me emrin e Fadil vatës.

Rilind Krasniqi - Lauretë pse nuk abstenuat në rastin e emërtimit të QKMF-së?

Aziz Bytyqi - Heroi Fadil Vata i plotëson të gjitha kushtet,sepse ka qenë kontribuues i jashtëzakonshëm për atdhe. I bëj ftesë këtij kuvendi që të merr vendim që bustit të Fadil Vatës me ja ndryshu vendin dhe ta bëjnë një bust më të madh,sepse ai bust është shumë i vogël. Edhe emërtimin e gjinnnazit e përkrahi.

Pika 6. - shtesë

Kryesuesi - kjo pike ka të bëjë me lirimin e taksave për gastronomet që shfrytëzojnë hapësirat publike.

Avni Bytyqi - jep sqarime shtesë si zyrtar ligjor. Pra të gjitha bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e gastronomisë dhe që bëjnë kërkesë për marrjen e pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirave publike për rreth lokaleve afariste lirohen nga pagesa për vitin 2021.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 7. Pyetje dhe përgjigje;

Kryesuesi - hap debatin për pikën 7.

Arbërim Basha - kërkesa për qëndrim ditor për fëmijët me autizëm, çka do të bëni me këtë kategori, dhe a ka mundësi për një pikë stacioni për ndaljen e autobusëve në fshatin Sllapuzhan?

Kryetari - në qoftes këtë vit përfundon qerdhja e re, atëherë kjo qerdhe kalon në objektin e ri, dhe objekti i tanishëm do ti shërbejë personave me autizëm. Dhe te pyetja e dytë, ajo pjesë e rrugës nuk është pjesë e Komunës, është magjistrale, dhe duhet të bëhet kërkesë.

Rilind Krasniqi - edhe rruga për Gjinoc dhe Shirokë është magjistrale, njejtë mundeni me vepru.

Laureta Tafa - cilës parti politike i takon Leonard Shala që ftohet në çdo takim, e unë jo?

Kryetari - në fillim i kem ftu ata kryesues të grupeve parlamentare, pastaj ata kanë lëviz në parti tjera, por ne e kemi atë listë.

Leonard Shala - kam dy shqetësime. Ka ankesë që ka shumë zhurmë te Interex natën dhe ju nuk iu keni kthyer përgjigje me shkrim, dhe dua të dijë kush merr qera për një antenë te stacioni i autobusëve që 15 vite?

Kryetari - Prona figuron në agjencionin e pyjeve Biraq dhe kur t'më informojnë, unë do t'ju tregoj.

Jehona Rrafshi - përshëndet të pranishmit. Për çështjen e zhurmës te Intrex janë bërë matje të zhurmës, dhe u konstatu që zhurma nuk është aq e madhe, mirëpo investitori ka premtu që do ta heq.

Leonard Shala - është kërkesë e palës që ju duhet t'ia ktheni me shkrim qytetarit.

Jehona Rrafshi - ne presim që shumë shpejt të rregullohet kjo dhe për atë nuk kemi kthyer përgjigje.

Jeton Rrakaqi - a kanë përfunduar punimet në shesh? Ato vazo që i keni vendos janë shumë të dobëta.

Kryetari - sheshi do të zbkurohet me lule. Kur të kryhet pranimi teknik do ta shihni dosjen.

Florije Bytyqi - punëtorët shëndetësor të Karitasit nuk marrin paga shtesë sikurse ne. A ka mundësi në bashkëpunim me drejtorin e shëndetësisë mi përkrah ata, sepse edhe ata janë të rrezikuar sikur ne.

Kryetari - kërkesat zyrtare janë të protokolume dhe i kemi dërgua. Kjo nuk po ndodh vetëm në Komunën tone, por në gjithë Kosovën. Ju garantoj që do ta bëjmë një kërkesë shtesë.

Dugagjin Palushi - rrugët lokale që janë ndërtu, janë të dëmtuara. A ka rend që ti rregulloni ato? Dhe personave me Covid, pse s'ka fillu ende pagesa e tyre?

Kryetari - ministria e financave ende nuk ka leju me bërë alokimin e mjeteve.

Takimi përfundoi: **11:45**

Procesmbajtësja:

Dafina Haziraj